



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1034/2024
Datë: 07 tetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenin 7, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 19 dhe 20 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, si dhe Raportit të Panelit Hetimor në rastin disiplinor AD.nr.6/2024, të datës 27 shtator 2024, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Prokurorëve Genc Nixha, Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda [REDACTED] gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 07 tetor 2024, në seancën e këshillimit e votimit mori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor AD.nr.6/2024, i datës 27 shtator 2024, në rastin disiplinor ndaj Prokurorit Genc Nixha, Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda [REDACTED]
- II. **VËRTETOHET** se, të Prokuror [REDACTED] Genc Nixha [REDACTED] janë gjetur elemente të përgjegjesisë disiplinore, në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe neni 6, paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.
- III. Prokurorit Genc Nixha, i shqiptohet sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim" në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- IV. [REDACTED]

Arsyetim

Më datë 17 korrik 2024, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Autoriteti Kompetent, ish Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDACTED] ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj [REDACTED]

[REDACTED] Prokurorit Genc Nixha, Departamenti i Krimeve të Rënda në Prokurorin Themelore në Prizren. Më datë 09 korrik 2024, "Betimi për Drejtësi" kishte zhvilluar një hulumtim lidhur me konsumimin e pijeve alkoolike mbrenda orarit zyrtar nga zyrtarët e sistemit të drejtësisë në Prizren. Gjatë këtij hulumtimi kishin hasur në prokurorin Genc Nixha [REDACTED] në kohën e pauzës, derisa ka [REDACTED] qenë në lokalin tek "Zhuri", afër objektit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, ka [REDACTED] konsumuar pije alkoolike "birrë" dhe në shoqëri të tyre në tavolinë ka [REDACTED] qenë [REDACTED] personi i quajtur [REDACTED] cili kishte qenë palë (i akuzuar), në një lëndë tek [REDACTED] [REDACTED], ku ishin inçizuar fshehurazi nga kameramani i "Betimit për Drejtësi".

Autoriteti Kompetent i ka rekomanduar Këshillit Prokurorial të Kosovës, që ndaj prokurorit [REDACTED] të lartëcekur, të shqiptohet sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim", konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, si dhe për shkak të shkeljes së nenit 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Me datë 01 gusht 2024, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nxjerr vendim me numër KPK/Nr.830/2024, për Themelimin e Panelit hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.6/2024, ndaj Prokurorit Genc Nixha, Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda [REDACTED]

Më datë 01 tetor 2024, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin AD.nr.6/2024, me të cilin ka ardhur në përfundim se, Prokurori Genc Nixha [REDACTED] ka [REDACTED] vepruar në shkelje të nenit 6, paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve, [REDACTED]

[REDACTED] Po ashtu, nga deklarata e subjektit të hetimit disiplinor Genc Nixha, nuk është kontestuar fakti se gjatë orarit të pauzës, ka qenë duke konsumuar alkool [REDACTED], përkundër se i njëjti e ka mohuar se konsumimi i alkoolit gjatë kohës së pauzës të konsiderohet orar i punës, edhe pse me përvojë tridhjetë e katër (34) vjeçare, si gjyqtar dhe prokurorë nuk e ka ditur se konsumimi i një birre [REDACTED] mund të jetë shkelje disiplinore, si dhe nuk e ka ditur se me ligjin e punës orari zyrtar llogaritet koha edhe gjatë pushimit ditor.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në seancën disiplinore të mbajtur më datë 07 tetor 2024, pas shqyrtimit të Raportit të dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të

Panelit Hetimor, i cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore, konstatimin e Panelit Hetimor se, prokurori [redacted] Nixha [redacted] ka ndërmarrë veprimet të cilat bien ndesh me Ligjin Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror.

Në seancën disiplinore ka [redacted] prezentuar edhe subjekt [redacted] hetimit disiplinor, prokurori Genc Nixha [redacted]. Në fjalën e tij përfundimtare prokurori Genc Nixha, ka deklaruar se: "Në parim nuk e kundërshtoj, pirja e birrës është fotografi edhe është pa në televizion, edhe aty unë nuk mundem edhe si njeri, po edhe si kolegu juaj (prokuror) me thon qe, nuk e kam pas birrën para vetes. Mirëpo, është e vërtetë se ka qenë koha e drekës, e vërtetë, bile aty është kontestuese në emision se, jo 11:45, ka qenë 12:15, ne kemi porositë me hangër drekë, ka qenë shumë nxehtë ditën kritike, nuk po du me arsyetu veten, dhe e kemi porositë ... nga një birrë me [redacted]. Nëse më besoni, unë edhe atë e kam deklaruar, e kam shokë njëzetepesë vjet (25), por ai është qasi far njeri qe kurr nuk më ka tregu se e kishte një landë në prokurori, po të ishte ashtu qe kam qenë në dijeni, se ai ka qenë i akuzum dhe i dënum, unë me siguri [redacted] nuk e kisha thirrë në tavolinë, nuk e kisha thirrë. Se jam qe tridhjetë e katër (34) vjet në sistem, dhe atë gabim nuk e kisha bë, do të thot, unë ditën kritike kur jam ulë me [redacted] jam ulë si me një shokë dhe fare nuk e kam ditë se ai ka landë. Për këtë arsye, ndoshta edhe komisioni në këtë drejtim nuk kanë mujt me gjetë qe unë kam qenë në dijeni për këtë rastë, se po të kisha qenë në dijeni, me siguri [redacted] nuk e kisha thirrë të ulet në tavolinë, mirëpo unë këtë qe po e them, ashtu është. Ai është ulë, edhe ai e ka porositë një birrë, edhe ashtu, na është afru një person të cilin e kemi pas karrshi... unë fare nuk e kam vërejtë se ai ka telefon në dorë, tek më vonë shankisti i restorantit vjen edhe thot, shiko se është duke ju fotografi, kaq, nuk kam çka të them diçka tjetër. Nuk kam qenë në dijeni, se një birrë është në kundërshtim me rregulloren e punë, unë pak u mundova me lexu atë rregullore. Aty në rregullore shkruan se, nëse konstatohet qe prokurori nuk ka qenë në gjendje për shkak të ndikimit të alkoolit, një birrë unë nuk e konsideroj se është pije me të cilën prokurorin e venë në një pozicion të palakmueshëm. Dy, unë i kam pas tre (3) gjykime ditën kritike, një (1) paraburgim dhe dy (2) gjykime të tjera. Unë pasdite nuk kam pas më gjykime tjera, prandaj edhe me të vërtetë nuk kam, nuk më ka shku mendja se me një (1) birrë mund ta bi veten në një pozicion të tillë. Jam qe tridhjetë e katër (34) vjetë gjyqtar dhe prokuror, vetëm një gjë, nuk e kam ditë se veprimi im është ndesh me rregulloren, nuk e kam ditë dhe çka të them. Mesiguri nuk e kisha leju veten, bile, bile, ndoshta po ju them edhe me shaka, ma shumë kam prit qe ju si këshillë të më thirrni edhe të më jepni një lavdatë, pasi që në muajin shtator të vitit të ardhshëm, dal në pension. Vetëm një gjë, nuk e kam ditë se veprimi im është ndesh me rregulloren, nuk e kam ditë dhe çka të them. Por, tash ja që ndodhi, kam ardhë krejtësisht në një situatë tjetër dhe gjindem para jush, kjo është e tëra, çka të them diçka tjetër".

[redacted]

[REDACTED]

Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, Subjekt [REDACTED] të Hetimit Disiplinor, shqyrtimit dhe analizimit, të provave të cekura në Raportin e Panelit, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe prokuror [REDACTED] Genc Nixha [REDACTED], erdhi në përfundim se, në rastin AD.nr. 6/2024, është vërtetuar shkelja disiplinore si në dispozitiv të këtij vendimi [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED] të cilat veprime vërtetohen edhe përmes videoinçizimit, deklaratave të [REDACTED] prokuror [REDACTED] - subjekt të hetimit disiplinor dhe nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Po ashtu, nga deklarata e subjektit të hetimit disiplinor Genc Nixha, nuk është kontestuar fakti se gjatë orarit të pauzës, ka qenë duke konsumuar alkool [REDACTED], përkundër se i njëjti e ka mohuar se konsumimi i alkoolit gjatë kohës së pauzës të konsiderohet orar i punës, edhe pse me përvojë tridhjetë e katër (34) vjeçare, si prokurorë nuk e ka ditur se konsumimi i një birre [REDACTED] mund të jetë shkelje disiplinore.

[REDACTED]

[REDACTED] është vërtetuar drejtë gjendja faktike se, prokurori Nixha [REDACTED] janë shoqëruar me ish të akuzuarin dhe [REDACTED] ka konsumuar "Birra" gjatë orarit të punës, ku ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi

1, pika 1.3 dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.10 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve,

Andaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, fjalës përfundimtare të tij, dëgjimit dhe fjalës përfundimtare të Subjekt [REDACTED] të Hetimit Disiplinor, me shumicë të votave erdhi në përfundim se, në rastin konkret AD.nr.6/2024, për prokurorin Genc Nixha është vërtetuar së në rastin konkret ka shkelje disiplinore dhe është shqiptuar sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim", [REDACTED]

[REDACTED], të cilat sanksione janë në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit Hetimor. Serioziteti i shkeljes disiplinore i kryer nga Prokurori Genc Nixha [REDACTED], pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilat është kryer shkelje, sjellja e përgjithshme e subjekt [REDACTED] të hetimit disiplinor, si dhe sjellja dhe bashkëpunimi në procedurë disiplinore, sanksionet disiplinore "Vërejtje publike me shkrim", ndaj prokurorit Genc Nixha, [REDACTED]

[REDACTED] në rrethana këto që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në mes të shkeljes disiplinore dhe sanksionit disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'u dërgohet:

- Z. Petrit Kryeziu, U.D Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren;
- Z. Genc Nixha, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren;
- Arkivit të KPK-së.